


4.4 PASQYRA E TERMAVE

Në formimin e pyetjeve për kërkim ju ndihmon funksioni *pasqyra e termave* (ikona .


Ky funksion mundëson vështrimin në listën e termave për kërkim, të cilët aktualisht ndodhen në bazën e të dhënave. Këta terma i përdorni kur dëshironi të siguroheni, nëse termi për kërkim është shënuar saktë.

Funksioni *pasqyra e termave* nuk është në dispozicion të fushat për kërkim "Fjalët kyçe" dhe "COBISS.XX-ID".

Procedura

1. Në fushën përkatëse për kërkim shënoni fillimin e pyetjes (p.sh. fillimin e titullit, mbiemrin e autorit...).

Nëse fillimin e termit për kërkim nuk e dini, fushën mund ta lini edhe të zbrazët.

2. Klikoni ikonën  afër fushës për shënimin e pyetjeve për kërkim.

Hapet dritarja **Pasqyra e termave**, në të cilën ndodhet lista e të gjithë termave, duke filluar nga pyetjet e shënuara për kërkim (ose nga termi i parë) e tutje. Lista është e rregulluar sipas rendit alfabetik në ngritje. Numri para çdo termi tregon se sa herë ky term paraqitet në bazën e të dhënave. Për të kaluar në faqen tjetër të listës klikoni butonin **Përpara**.



Shënim:

Termet për kërkim, të cilët ndodhen në listë nuk përmbajnë shenjën për klasifikim "≠" (NSB/NSE).

3. Në listë gjeni dhe përzgjidhni vlerën e dëshiruar.

Këtë mund ta bëni në dy mënyra:

- përzgjidhni vlerën dhe konfirmojeni atë duke klikuar butonin **Në rregull**
- përdorni tastet për zhvendosje <left>, <right>, <PgUp>, <PgDn> dhe klikoni tastin <Enter>


Vlera e përzgjedhur transferohet në fushën për shënimin e pyetjes për kërkim.



Këshillë:

Mënyra më e shpejtë për të përzgjedhur një vlerë nga lista e termave, është të klikoni dy herë mbi të.

**Shembull:**

Nëse dëshironi të gjeni të gjithë autorët me mbiemrin Dickens, tek "Autor – person" shënoni *dickens* dhe klikoni ikonën  afër fushës për kërkim. Në dritaren **Pasqyra e termave** shfaqet lista e autorëve, mbimri i të cilëve fillon me *dickens*.